



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 20.11.2016]

Për: Operatorin Ekonomik “Curri” shpk

Procedura e prokurimit: **“Tender i Hapur”** me objekt : **“Ndertim i ujesjellesit Cerme – Terbuf – Sulzotaj”**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Ndertim i ujesjellesit Cerme – Terbuf – Sulzotaj”**.

Kohëzgjatja: brënda 10 muajsh nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: **387.000.000 (treqind e tetedhjetë e shtatë milion)** lekë pa tvsh.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 26.10.2016.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	OPERATORI EKONOMIK	VLERA E OFERTES PA TVSH PARA KONTROLLIT ARITMETIK
1	RIVIERA	301,495,714
2	N.T.P. Eurokos-Dega ne Shqiperi	305,314,648
3	NDREGJONI	318,679,838
4	GJOKA KONSTRUKSION	333,122,999
5	KEVIN KONSTRUKSION	357,738,828
6	"SHKELQIMI 07"	369,477,984
7	CURRI	371,236,432
8	ALB - STAR	383,169,004
9	KRENAR CANI	NUK KA PARAQITUR DOKUMENTACION

Pas vleresimit të dokumentacionit të paraqitur komisioni me unanimitet vendosi të skualifikojë shoqerite:

Bashkimi i Operatoreve Ekonomike “Riviera” shpk (30%) dhe “Bitupave” (70%) pasi:

Shoqeria “Riviera” shpk nuk ploteson kërkesën 2.2.4 për kualifikim lidhur me taksat vendore pasi sipas QKR ka kryer aktivitet në Lukovë (2014), Diber (2014), Dajç Shkoder (2014), Hekal Mallakaster (2014), Shkoder (2014), Otlak Berat (2014), Shenavlash Durrës (2014 -2015), Kakomë Sarandë (2014-2015) dhe për këto detyrime vendore nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion. Edhe deklarata e paraqitur për të plotësuar kërkesën 2.2.5 për kualifikim rezultoi e pa vertetë.

Shoqeria “Riviera” shpk nuk ploteson kërkesën 2.3.1 për kualifikim lidhur me punët e ngjashme pasi ka paraqitur 3 punë si punë të ngjashme:

1. Kontrata Prishtine – Millosheve: Ne kete kontrate gjithesej vlere punime ujesjellesa eshte 66.611 euro nga 52.245.000 leke qe duhet te jete sipas perqindjes se punes qe shoqeria ka marre persiper. Ne kete menyre vetem me kete pune nuk e ploteson kerkesen.
2. Kontrata sistemim asfaltim berat buzuq loti 1 nuk mund te konsiderohen si pune te ngjashme pasi jane punime rrugore.
3. Kontrata ujesjellesi kakome mund te konsiderohet si pune e ngjashme, por per kete pune nuk ka paraqitur lejen e ndertimit ne kundertshtim me kerkesen per kualifikim. Gjithashtu edhe fatura tatimore e dates 10.06.2014, akti i kolaudit i dates 7.9.2014 dhe akti i marrjes ne dorezim i dates 10.9.2015 per kete objekt jane te pasakte pasi si administrator i "Riviera Kakome" shpk ka firmosur zoti Jeko Kolev i cili ka qene shkarkuar qe ne daten 8.4.2014. Ne kete menyre firmat e tij jane te pavlefshme dhe fiktive.

Shoqeria "Bitupave" nuk ploteson kerkesen 2.2.4 per kualifikim lidhur me taksat vendore pasi sipas QKR rezulton se eshte regjistruar me seli ne Tirane ne daten 25.09.2015 dhe nuk ka paraqitur vertetim per likuidimin e detyrimeve per taksat vendore per vitin 2015.

Shoqeria "Bitupave" nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi ne punen e deklaruar ka realizuar vetem punime me tubacione metalike dhe nuk ka deklaruar asnje eksperience lidhur me tubacionet HDPE.

Shoqeria "Bitupave" nuk ploteson kerkesen 2.3.7 per kualifikim lidhur me mjetet dhe paisjet pasi ka marre persiper te kryeje 70% te punimeve, nder te cilat punime me tubacionet HDPE dhe nuk disponon makineri per saldimit elektrofuziv te tubave HDPE, nuk disponon autobot uji i cili eshte i domosdoshem per kryerjen e provave nen presion, nuk disponon pompe presioni per testimin hidraulik te linjave te ujesjellesit.

Bashkimi i Operatoreve Ekonomike nuk ploteson kerkesen 2.3.10 per kualifikim lidhur me cilesine e materialeve qe do te vendosen ne veper, pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per tubat HDPE, saracineskat, rakorderite dhe matesat e ujit.

Bashkimin e Operatoreve Ekonomike "Eurokos" shpk (65%) dhe "Alfa.I" (35%) pasi:

Shoqeria "Eurokos" shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.3 per kualifikim lidhur me gjendjen ne banke pasi ka paraqitur dokumentacion per disponimin e shumes 25.000.000 leke nga 25.155.000 leke qe duhet te kishte duke ju referuar perqindjes se puneve qe ka marre persiper (65%).

Shoqeria "Eurokos" shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi ne punen e deklaruar me objekt "Rikonstruksion i rruges Kukes Shishtavec" nuk ka kryer punime me tubacione metalike, nderkohe qe, sipas marreveshjes se bashkepunimit, ka marre persiper te kryeje punime ndertim montimi per 107 ton tubacione celiku.

Shoqeria "Alfa.I" shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.7 per kualifikim lidhur me mjetet e paisjet pasi nuk ka ne dispozicion pompe presioni per kryerjen e testeve nen presion, ndonese ka marre persiper punimet ne linjat e ujesjellesit.

Bashkimin e Operatoreve Ekonomike "Ndregjoni" shpk (35%) dhe "Sterkaj" shpk (65%) pasi:

Shoqeria “Ndregjoni” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.5 per kualifikim lidhur me punesimin e mjekut te shoqerise pasi nuk ka paraqitur licensen e kerkuar ne kriterin per kualifikim.

Shoqeria “Ndregjoni” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.9 per kualifikim lidhur me certifikatat ISO pasi nga verifikimi ne sistem rezulton se certifikatat ISO 9001:2008, PAS 99:2012 dhe ISO 39001:2012 leshuar nga CERTIND jane te pavlefshme (anuluara).

Shoqeria “Sterkaj” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me taksat vendore pasi nuk ka paraqitur vertetime per pagesen e detyrimeve ne Shkoder-Velipoje-Pulaj ku ka ushtruar aktivitet deri ne daten 18.12.2014.

Shoqeria “Sterkaj” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi per punen e deklaruar nuk ka paraqitur formularin e vleresimit sipas shtojces 8, sic eshte kerkuar ne kriterin per kualifikim.

Shoqeria “Sterkaj” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.4 per kualifikim lidhur me deklaraten per mosangazhimin e inxhinierëve pasi nuk e ka paraqitur deklaraten e kerkuar.

Shoqeria “Sterkaj” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.5 per kualifikim lidhur punesimin e mjekut te shoqerise pasi zoti Ferdinand Bocaj (i punesuar si mjek) eshte infermier dhe jo mjek.

Operatorin Ekonomik “Gjoka” shpk pasi:

Nuk ploteson kerkesen 2.2.4 per kualifikim lidhur me taksat vendore pasi nuk ka paraqitur vertetime per pagesen e detyrimeve ne Korce ku ka ushtruar aktivitet deri ne daten 08.06.2015, Berat ku ka ushtruar aktivitet deri ne 05.09.2014 dhe ne Karpen Kavaje ku ushtron aktivitet.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi ne punen e deklaruar me objekt “Ndertimi i hidrocentraleve “Lenie”, “Shales” dhe “Strelce” punimet i perkasin kategorise se licenses NP10 dhe nuk mund te konsiderohen si punime te ngjashme. Nga shqyrtimi i zerave te punimeve rezulton se nuk ka kryer punime tubacionesh HDPE dhe nuk rezulton te kete pervoja te tjera te ngjashme me punime qe i perkasin kategorise NP7.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.10 per kualifikim lidhur me cilesine e materialeve qe parashikohet te vendosen ne veper, pasi ka paraqitur dokumentacion nga shoqeria “Teqja International” lidhur me tubacionet HDPE. Nga dokumentacionet e paraqitura rezulton se kjo shoqeri nuk prodhon tubacione HDPE-RC sipas specifikimeve teknike te dhena ne tender.

Mungon certifikata e cilesise per saracineskat, rakorderite dhe matesat e ujit.

Bashkimi e Operatoreve Ekonomike “Kevin Konstruktion” shpk (51%) dhe “Boshnjaku B” (49%) pasi:

Ne marreveshjen e bashkepunimit te lidhur ndermjet dy shoqerive nuk jane percaktuar punet konkrete qe do te kryeje secila shoqeri. Ne kete menyre komisioni gjykon se te gjithë zerat e punimeve do te realizohen nga te dyja shoqerite, ne perputhje me perqindjen e punes te percaktuar ne marreveshje.

Shoqeria “Kevin Konstruksion” shpk nuk ploteson kërkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi punet e deklaruar jane punime ndertim e rikonstruksion godinash dhe nuk ka asnje punim ujesjellesi.

Shoqeria “Kevin Konstruksion” shpk nuk ploteson kërkesen 2.3.2 per kualifikim lidhur me numrin e punonjesve pasi sipas perqindjes se puneve qe ka marre persiper (51%) duhet te kishte nje numer mesatar te punesuarish prej jo me pak se 71 personash, nderkohe qe numri mesatar per periudhen e kerkuar shkurt 2016 – gusht 2-16 eshte 67 persona.

Shoqeria “Kevin Konstruksion” shpk nuk ploteson kërkesen 2.3.9 per kualifikim lidhur me certifikatat ISO pasi nga verifikimi ne sistem rezulton se certifikata ISO 14001:2004, certifikata PAS 99:2012 dhe certifikata ISO 39001:2012 leshuar nga AQSCERT jane te pavlefshme.

Shoqeria “Boshnjaku B” shpk nuk ploteson kërkesen 2.2.3 per kualifikim lidhur me gjendjen ne banke pasi ka paraqitur dokumentacion per disponimin ne ABI Bank te shumes 5.060.556 leke nga 18.963.000 qe duhet te kishte sipas marreveshjes se bashkepunit (49%).

Shoqeria “Boshnjaku B” shpk nuk ploteson kërkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi nga punet e deklaruar vetem punet e meposhtme mund te konsiderohen si pune te ngjashme:

NR	PUNA	ME TVSH	PA TVSH	%	REALIZUAR	SHENIME
1	UJESJELLESI ALGJINAJ	19,611,191	16,342,659	40.9	6,684,147.60	MUNGON MARREVESHJA BASHKEPUNIT E
2	FURNIZIM ME UJE ROSKOVEC	37,350,521	31,125,434	90	28,012,890.75	MUNGON MARREVESHJA BASHKEPUNIT E
3	REHABILITIMI I UJESJELLESIT DUSHK	8,624,528	7,187,107	100	7,187,106.67	
4	UJESJELLESI KURJAN	99,527,253	82,939,378	41.7	34,585,720.42	MUNGON MARREVESHJA BASHKEPUNIT E
5	UJESJELLESI LUGU I DARDHES SARANDE	148,532,342	123,776,952	7	8,664,386.62	MUNGON MARREVESHJA BASHKEPUNIT E

Nga punet e mesiperme ka paraqitur dokumentacion te plote vetem per punen me objekt “Rehabilitimi i ujesjellesit Dushk” me vlere 7.187.106 leke pa tvsh nga 85.333.500 leke pa tvsh qe duhet te paraqiste bazuar ne perqindjen e puneve qe ka marre persiper. Per punet e tjera (te cilat jane realizuar si bashkim operatoresh ekonomike) nuk ka paraqitur marreveshjet e bashkepunit ne perputhje me kërkesen per kualifikim, dhe ne kete menyre keto pune nuk mund te merren ne konsiderate.

Bashkimi e Operatoreve Ekonomike “Shkelqimi 07” shpk (42%) & “SMO Union” shpk (25%) & “Grand Konstruksion” shpk (18%) & “Shendelli” shpk (15%) pasi:

Ne marreveshjen e bashkepunimit te lidhur ndermjet shoqerive eshte percaktuar se secila shoqeri do te kryejë punime per te gjithë zerat e punimeve ne raport me perqindjen e punes qe ka marre persiper. Ne kete menyre komisioni gjykon se secila kompani me vehte duhet te zoteroje kapacitete te mjaftueshme per te kryer cdo ze punimi te parashikuar ne preventiv.

Shoqeria “Shkelqimi 07” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.4 per kualifikim lidhur me taksat vendore pasi nuk ka paraqitur vertetime per shlyerjen e detyrimeve vendore per ne Fier ne vitin 2014 (sipas QKR ka ushtruar aktivitet deri ne qershor 2014).

Shoqeria “Shkelqimi 07” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi nga punet e deklaruar vetem punet e meposhtme mund te konsiderohen si pune te ngjashme:

NR	PUNA	ME TVSH	PA TVSH	%	REALIZUAR
1	NDERTIM DEPO 1000 M3	69,172,017	57,643,348	100	57,643,347.50
2	UJESJELLESJI GRESHICE	62,012,993	51,677,494	100	51,677,494.17
	SHUMA				109,320,841.67

Si shoqeria me perqindjen me te madhe ne bashkim duhet te paraqiste dokumentacion per realizimin e nje objekti te vetem te ngjashem me vlere jo me pak se 174.150.000 leke pa tvsh ose te shume objekteve te ngjashem me vlere te pergjithshme jo me pak se 325.000.000 leke. Me objektet e deklaruar nuk ploteson asnjërin kusht.

Shoqeria “SMO Union” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi si pune e ngjashme mund te konsiderohet vetem puna ”Furnizimi me uje cesme – Gruemire 2” me vlere 13.931.152 leke me tvsh. Bazuar ne perqindjen e punes qe ka marre persiper (25%) duhet te vertetonte se ka kryer pune te ngjashme ne nje objekt te vetem ne vlere jo me pak se 43.537.500 leke ose ne shume objekte te ngjashem ne vlere 193.000.000 leke pa tvsh. Me objektet e deklaruar nuk ploteson asnjë prej kushteve.

Shoqeria “SMO Union” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.7 per kualifikim lidhur me mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per disponimin e:

- *Impiant automatik betoni*
- *Autobot uji*
- *Freze asfalti*
- *Autobetoniere*
- *Makineri sonde per cpime horizontale (per kalim tubash nen trasene e rruges)*
- *Pompe presioni per testimin hidraulik te linjave te ujesjellesit*

Ne marreveshjen e bashkepunimit te lidhur ndermjet shoqerive eshte percaktuar se secila shoqeri do te kryejë punime per te gjithë zerat e punimeve ne raport me perqindjen e punes qe ka marre persiper. Ne kete menyre komisioni gjykon se secila kompani me vehte duhet te zoteroje mjete e

paisje te nevojshme per te kryer cdo ze punimi te parashikuar ne preventiv. Duke qene se nuk disponon mjetet e mesiperme, kjo shoqeri nuk ka kapacitetet e nevojshme per te kryer punime ujesjellesi, betoni dhe cpime horizontale.

Shoqeria “Grand Konstruksion” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem teknik pasi nuk ka paraqitur dokumentacion se ka si te punesuar dhe te regjistruar ne kompanine e tij 1 (një) inxhiner mekanik, 1 (një) inxhinier gjeolog dhe 1 (një) inxhinier topograf. Ne marreveshjen e bashkepunimit te lidhur ndermjet shoqerive eshte percaktuar se secila shoqeri do te kryeje punime per te gjithë zerat e punimeve ne raport me perqindjen e punes qe ka marre persiper. Ne kete menyre komisioni gjykon se secila kompani me vehte duhet te zoteroje stafin e nevojshem teknik per te kryer cdo ze punimi te parashikuar ne preventiv. Duke qene se nuk disponon specialistet e mesiperm, kjo shoqeri nuk ka kapacitetet e nevojshme per te kryer te gjithë punimet e parashikuara ne preventiv.

Shoqeria “Grand Konstruksion” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.5 per kualifikim lidhur me punesimin e mjekut te shoqerise pasi nuk ka paraqitur asnje nga dokumentat e kerkuar ne kriterin per kualifikim.

Shoqeria “Grand Konstruksion” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.6 per kualifikim lidhur me pikat e licenses qe duhet te disponoje pasi nuk disponon pikat e licenses N.S – 9 (Punime strukturorë speciale), N.S – 18 (Punime topogjeodezike) dhe N.S.- 20 (Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë).

Ne marreveshjen e bashkepunimit te lidhur ndermjet shoqerive eshte percaktuar se secila shoqeri do te kryeje punime per te gjithë zerat e punimeve ne raport me perqindjen e punes qe ka marre persiper. Ne kete menyre komisioni gjykon se secila kompani me vehte duhet te zoteroje te gjithë pikat e kerkuara te licenses per te kryer cdo ze punimi te parashikuar ne preventiv. Duke qene se nuk disponon pikat e mesiperme te licenses, kjo shoqeri nuk ka kapacitetet e nevojshme per te kryer te gjithë punimet e parashikuara ne preventiv.

Shoqeria “Grand Konstruksion” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.7 per kualifikim lidhur me mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per disponimin e:

Autobot uji

Freze asfalti

Mjet autovinç

Makineri sonde per cpime horizontale (per kalim tubash nen trasene e rruges)

Pompe presioni per testimin hidraulik te linjave te ujesjellesit

Makineri per saldimin elektrofuziv te tubave HDPE

Ne marreveshjen e bashkepunimit te lidhur ndermjet shoqerive eshte percaktuar se secila shoqeri do te kryeje punime per te gjithë zerat e punimeve ne raport me perqindjen e punes qe ka marre persiper. Ne kete menyre komisioni gjykon se secila kompani me vehte duhet te zoteroje mjete e paisje te nevojshme per te kryer cdo ze punimi te parashikuar ne preventiv. Duke qene se nuk disponon mjetet e mesiperme, kjo shoqeri nuk ka kapacitetet e nevojshme per te kryer punime ujesjellesi.

Shoqeria “Shendelli” shpk nuk ploteson kërkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi nuk ka deklaruar asnje objekt te ngjashem me punimet e ujesjellesave. Vetem ne objektin “Rruga Ballsh” ka kryer punime ujesjellesi ne vleren 35.160 leke pa tvsh. Me objektet e deklaruar nuk ploteson asnje prej kushteve.

Operatorin Ekonomik “Krenar Cani” shpk pasi: Nuk ka paraqitur dokumentacion.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Curri” shpk** se oferta e paraqitur, me vlerë **378,230,996 (treqind e shtatedhjete e tete milion e dyqind e tridhjetë mijë e nenteqind e nentehjete e gjashte)** lekë pa TVSH (pas korigjimit te gabimeve aritmetike) është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Samë Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **10.11.2016**.

Ne daten 30.09.2016 paraqiti ankese per dokumentat e tenderit shoqeria “Be-Is” shpk. Ankeses ju kthye pergjigje ne daten 05.10.2016.

Ankesa te tjera nuk ka patur.